

Udhëzime për Ndryshimin e Cilësimeve të Gjuhës në Shfletuesit e Uebit (Web)

Google Chrome

1. Klikoni ikonën e menu-së me tre pika (:) në këndin e sipërm në anën e djathtë.
2. Shkoni tek **Cilësimet (Settings)**, pastaj shkoni tek seksioni **Gjuhët (Languages)**. Një shkurtim është të shkruash `chrome://settings/languages` në shiritin e adresës.
3. Nën "Gjuhët e preferuara" (Preferred Languages), klikoni **Shtoni gjuhët (Add languages)**.
4. Klikoni kutinë pranë gjuhës së dëshiruar dhe klikoni **Shtoni (Add)**.
5. Klikoni menunë me tre pika (:) pranë gjuhës së shtuar rishtas.
6. Zgjidhni **Zhvendosni në krye (Move to the top)** për ta vendosur si gjuhën e parazgjedhur për faqet e internetit, ose zgjidhni **Shfaq Google Chrome në këtë gjuhë (Display Google Chrome in this language)** për të ndryshuar gjuhën e ndërfaqes së shfletuesit (vetëm në Windows).
7. Rihapni Chrome për të aplikuar ndryshimet.

Mozilla Firefox

1. Klikoni ikonën e menu-së me tre rreshta (:) në këndin e sipërm në anën e djathtë dhe zgjidhni **Cilësimet (Settings)**.
2. Në panelin "Të përgjithshme" (General), shkoni poshtë te seksioni **Gjuha (Language)**.
3. Klikoni në menu-në zbritëse dhe zgjidhni një gjuhë tashmë të listuar ose klikoni **Kërko për më shumë gjuhë (Search for more languages) ...** për të shtuar një të re.
4. Nëse po shtoni një gjuhë të re, zgjidhjeni atë nga lista dhe klikoni **Shtoni (Add)**, dhe pastaj **OK**.
5. Përdorni butonin **Lëviz Lart (Move Up)** për të zhvendosur gjuhën tuaj të preferuar në krye të listës.
6. Klikoni **Aplikoni dhe Rinisni (Apply and Restart)** për të ruajtur ndryshimet.

Microsoft Edge

1. Klikoni ikonën e menuesë me tre pika (...) në këndin e sipërm në anën e djathtë dhe zgjidhni **Cilësimet (Settings)**.
2. Klikoni **Gjuhët (Languages)** nga menu-ja në të majtë.
3. Klikoni **Shtoni gjuhët (Add Languages)** për të gjetur dhe shtuar gjuhën që ju dëshironi.
4. Klikoni menunë me tre pika (...) pranë gjuhës që sapo shtuat.

5. Zgjidhni **Zhvendosni në krye (Move to the top)** për faqet e internetit ose zgjidhni **Shfaqni Microsoft Edge në këtë gjuhë (Display Microsoft Edge in this language)** dhe pastaj klikoni
6. **Rinisni** për të ndryshuar gjuhën.

Safari (Desktop)

Gjuha e Safari kontrollohet nga cilësimet e sistemit macOS, kështu që ndryshimi i saj do të ndryshojë gjithashtu gjuhën e shfaqjes edhe për aplikacionet e tjera.

1. Klikoni **menu-në Apple** në këndin e sipërm në anën e majtë dhe zgjidhni **Cilësimet e Sistemit (System Settings)** (ose **Preferencat e Sistemit (System Preferences)** në versionet më të vjetra të macOS).
2. Klikoni **Të përgjithshme (General)**, pastaj **Gjuha dhe Rajoni (Language & Region)**.
3. Rreshkisni gjuhën e preferuar në krye të listës "Gjuhët e preferuara" (Preferred Languages).
4. Konfirmoni ndryshimin në njoftimin që shfaqet.
5. Rinisni Safarin që ndryshimet të hyjnë në fuqi.

Safari (Mobile)

Në mënyrë të ngjashme me macOS, gjuha në Safari në një iPhone ose iPad kontrollohet nga cilësimet në të gjithë sistemin.

1. Shkoni te **Cilësimet (Settings)**, pastaj te **Të Përgjithshme (General)**.
2. Prekni te **Gjuha dhe Rajoni (Language & Region)**.
3. Rreshkisni gjuhën e preferuar në krye të listave të **Renditjes së Gjuhëve të Preferuara (Preferred Language Order)**.
4. Rinisni Safari-n për të aplikuar ndryshimet